

1 E shtunë, 4 nëntor 2023

2 [Paraqitja e parë]

3 [Seancë e hapur]

4 [I dyshuari hyn në sallën e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 10.00

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëmëngjesi, mirë se
7 erdhët të gjithë ju që jeni në sallën e gjyqit dhe që na
8 ndiqni jashtë sallës së gjyqit.

9 Përpara se të fillojmë në vijim të Vendimit tim për
10 Urdhër Transferimi në Vijim të Arrestimit nga Prokurori i
11 Specializuar, fotografi i Gjykatës duhet të bëjë disa
12 fotografi dhe lejohet të bëjë disa fotografi për një minutë e
13 gjysmë.

14 Zonja fotografe, mund të bëni fotografitë.

15 Faleminderit.

16 Sekretare e Gjykatës, ju lutem të paraqisni lëndën.

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Kjo është
18 lënda me numër KSC-BC-2018-01.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

20 Përpara se t'u kërkoj personave të prezantohen, dua t'u
21 kujtoj të gjithëve që ka disa rregulla që duhen respektuar
22 gjatë gjithë kohës në mënyrë që procesi gjyqësor të shkojë
23 fjollë.

24 Ju lutem, ndizni mikrofonat kur të flisni dhe t'i fikni
25 mikrofonat kur të keni mbaruar fjalën tuaj. Flisni ngadalë,

1 flisni qartë, se kemi përkthim në shqip dhe serbisht. Prisni
2 pesë sekonda përpara se të më përgjigjeni mua apo palës apo
3 pjesëmarrësit në mënyrë që përkthyesit të kenë mundësi të
4 përfundojnë përkthimin.

5 Çfarëdo që thuhet në këtë seancë përcillet në kohë reale
6 dhe do të reflektohet në transkriptin që u vihet në
7 dispozicion palëve dhe publikut pas seancës.

8 Do të doja t'u kujtoja palëve që disa informacione në
9 këtë çështje gjyqësore janë objekt i masave mbrojtëse dhe
10 urdhrave të konfidencialitetit. Informacioni i tillë nuk duhet
11 thënë në seancë të hapur. Nëse pala apo pjesëmarrësi duhet të
12 kalojnë në seancë private, për të thënë informacione
13 konfidenciale, ju lutem të jepni dhe arsyet për këtë.

14 Tani, ftoj palët dhe pjesëmarrësit të prezantohen duke
15 filluar me Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

16 Z. Prokuror, fjala është për ju.

17 Z. HALLING: [Përkthim] Mirëmëngjes të nderuar Gjykatës,
18 për ZPS-në është Clare Lawson, Line Pederson dhe unë, Matt
19 Halling.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror,
21 Mbrojtja. Avokat?

22 Z. EDWARDS: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar Gjykatës.
23 Mirëmëngjes të nderuar kolegë, quhem Iain Edwards. Jam nga
24 Dhoma e Avokatisë së Anglisë dhe Uellsit dhe përfaqësoj këtu
25 z. Kilaj.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Edwards.

2 Zyra Administrative?

3 Z. ROCHE: [Përkthim] Mirëmëngjes, quhem Ralph Roche dhe
4 jam këtu në emër të Zyrës Administrative.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Roche.

6 Për procesverbal unë jam Nicholas Guillou, Gjykatës i
7 Vetëm në këtë çështje gjyqësore.

8 I dyshuari shfaqet sot për herë të parë para Dhomave të
9 Specializuar pas arrestimit dhe transferimit të tij.

10 Tani dua t'i drejtohem të dyshuarit. Z. Kilaj a mund të
11 çoheni në këmbë?

12 Z. Kilaj, a mund të na thoni emrin dhe mbiemrin tuaj?

13 I DYSHUARI: Unë quhem Isni Kilaj.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Cila është data juaj e
15 lindjes dhe vendlindja juaj?

16 I DYSHUARI: 11.12.1963, vendlindja Lubishtë, komuna
17 Malishevë.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Cila është nënshtetësia
19 juaj?

20 I DYSHUARI: Kosovës.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Çfarë profesioni keni
22 aktualisht?

23 I DYSHUARI: Ekonomist, jam i papunë.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, mund të uleni
25 z. Kilaj.

1 Z. Kilaj, përpara se të vazhdojmë më tej dua të sigurohem
2 që ju po e ndiqni procesin gjyqësor në një gjuhë që ju e
3 kuptoni dhe e flisni. A mund të konfirmoni se e kuptoni dhe e
4 flisni gjuhën shqipe?

5 I DYSHUARI: Po.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Kilaj. Me
7 këtë që thatë, unë tashmë jam i bindur që ju mund ta ndiqni
8 procesin gjyqësor në shqip, që është gjuha që ju e kuptoni dhe
9 e flisni në përputhje me nenin 41 të Ligjit.

10 Nëse gjatë procesit gjyqësor ndodh që nuk merrni
11 përkthim, ju lutem më vini menjëherë në dijeni.

12 Tani kalojmë te historiku procedural i kësaj çështje
13 gjyqësore.

14 Më 2 nëntor 2023, Prokurori i Specializuar lëshoi fletë-
15 arrestim kundër z. Hisni Kilaj në përputhje me nenet 35(2) dhe
16 41 të Ligjit.

17 Po në të njëjtën ditë, Zyra e Prokurorit të Specializuar
18 njoftoi Kryetarin e Gjykatës dhe Administratorin lidhur me
19 arrestimin e z. Kilaj, në bazë të rregullës 52(1) të
20 Rregullores së Procedurës dhe Provave.

21 Në përputhje me fletë-arrestimin, Prokurori i
22 Specializuar konstatoi se ekziston dyshim i bazuar që z. Kilaj
23 është përgjegjës penal për veprat penale të mëtejshme kundër
24 administrimit të drejtësisë: Konkretisht, pengim i personave
25 zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, në vijim në bazë të

1 nenit 401 të Kodit Penal të Kosovës; dhe së dyti, shkelja e
2 fshehtësisë së procedurës në bazë të nenit 392 të Kodit Penal
3 të Kosovës.

4 Dhomat e Specializuara kanë juridiksion për të ndjekur
5 penalisht këto vepra penale në bazë të nenit 15(2) të Ligjit.

6 I dyshuari u arrestua në Kosovë më 2 nëntor 2023, dhe në
7 atë moment iu dorëzua fletë-arrestimi dhe u informua mbi të
8 drejtat e tija.

9 Në bazë të Urdhrit tim për transferimin në objektin e
10 paraburgimit të Dhomave të Specializuara, z. Kilaj u
11 transferua në objektin e paraburgimit në Hagë, më 3 nëntor
12 2023.

13 Tani, më lejoni t'ju shpjegoj cili është qëllimi konkret
14 i paraqitjes së parë, që ta kuptojë vetë i dyshuari dhe për
15 ata që na ndjekin nga galeria publike por edhe përmes
16 internetit.

17 Seanca e sotme nuk është seancë gjyqësore. I dyshuari
18 ende nuk është ngarkuar ende me akuza, çka do të thotë se nuk
19 është dorëzuar ende aktakuza nga Prokurori i Specializuar. Nuk
20 do të paraqitet apo diskutohet asnjë provë sot, dhe nuk do të
21 diskutohet apo vendoset sot fajësia apo pafajësia e të
22 dyshuarit.

23 Qëllimi i seancës sot, trajtohet në nenin 41 të Ligjit
24 dhe rregullën 55 të Rregullores. Në bazë të këtyre
25 dispozitave, unë si Gjykatësi i vetëm, duhet të sigurohem që i

1 dyshuari është informuar mbi arsyet për arrestimin e tij,
2 gjegjësisht vepra penale që pretendohen se janë kryer dhe
3 arsyet pse po mbahet në paraburgim, dhe nëse i dyshuari është
4 informuar mbi të drejtat e tij sipas ligjit dhe Rregullores,
5 gjithashtu përfshihet këtu edhe e drejta për të pasur avokat.

6 U kërkoj palëve që të kenë parashtrime sa më të shkurtra
7 lidhur me këtë aspekt sepse unë do t'i marr një për një. Nëse
8 ndonjë prej palëve dëshiron të diskutojë ndonjë aspekt që nuk
9 është paraparë në kontekstin e paraqitjes së parë, ju lutem që
10 ta bëni këtë me shkrim duke dorëzuar një parashtrim të
11 protokolluar për mua.

12 Së pari, a mund t'ju konfirmoj, z. Kilaj, të më
13 konfirmoni se keni marrë fletë-arrestimin më datë 2 nëntor
14 2023 në një gjuhë që ju e kuptoni dhe e flisni?

15 I DYSHUARI: Po.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Kilaj.

17 Tani i drejtohem ZPS-së të paraqesë arsyet për arrestimin
18 e z. Kilaj sikurse paraqiten në fletë-arrestim.

19 z. Prokuror, fjala është për ju.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

21 Gjatë kontrollit të banesës së z. Kilaj, që u bë më 2
22 nëntor 2023, ZPS-ja evidentoi dhe gjeti materiale që lidhen me
23 dëshmitarët dhe është te materialet konfidenciale. Këto
24 materiale lidhen drejtpërdrejt me proceset gjyqësore të DHSK-
25 së dhe ishte informacion konfidencial të cilin z. Kilaj

1 ligjërisht nuk duhet ta mbante dhe s'kishte asnjë autorizim
2 për të pasur një informacion të tillë.

3 Duke pasur informacion të tillë, do të thotë që shkeljet
4 e fshehtësisë së procedurës penale, dhe kjo është një arsye e
5 bazuar për ne që të kuptojmë që ky material do të përdoret për
6 të ndërhyrë në procesin e drejtësisë dhe pengimin e procesit
7 gjyqësor.

8 Provat tregojnë se z. Kilaj është përgjegjës penalisht
9 për të kryer qoftë vetëm apo bashkë me të tjerë vepra penale
10 ku përfshihen pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave
11 zyrtare, sipas nenit 401 të Kodit Penal të Kosovës së vitit
12 2019, dhe shkelja e fshehtësisë së procedurës në bazë të nenit
13 392 të Kodit Penal i kombinuar me nenin 15(2) dhe 16(3) të
14 Ligjit të Dhomat e Specializuara.

15 Faleminderit.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Prokuror.

17 z. Kilaj, dua t'ju kujtoj se sot nuk është dita për të
18 kontestuar arrestimin tuaj, por thjesht për t'u siguruar që ju
19 jeni informuar dhe jeni në dijeni lidhur me arsyet e
20 arrestimit tuaj. Do të keni mundësi ta kundërshtoni me shkrim
21 arrestimin tuaj përmes Avokatit tuaj.

22 Z. Kilaj, a mund të na konfirmoni se jeni informuar
23 lidhur me arsyet për arrestimin tuaj?

24 I DYSHUARI: Po.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Gjithashtu, a mund të

1 konfirmoni në këtë kontekst se keni pasur mundësi të njoftoni
2 me anëtarë të familjes apo personat e tjerë të përshtatshëm
3 për arrestimin tuaj?

4 I DYSHUARI: Po.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Kilaj.

6 Tani do t'ju informoj lidhur me të drejtat në këtë
7 gjykatë.

8 Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Rregulla e
9 Procedurës dhe Provave garantojnë personat e ndaluar lidhur me
10 disa të drejta. Do ju lexoj të drejtat më të rëndësishme.

11 Së pari, do të prezumoheni i pafajshëm derisa të
12 vërtetohet fajësia juaj përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

13 Keni të drejtën për një seancë publike dhe të drejtë,
14 objekt i masave mbrojtëse që urdhërohen për mbrojtjen e
15 viktimave dhe dëshmitarëve.

16 Keni të drejtë të kundërshtoni ligjshmërinë e arrestimit
17 tuaj dhe të kërkonte rishikimin e vendimit për paraburgimin
18 tuaj dhe të apelonit vendime të tilla drejtpërdrejt para
19 Gjykatës së Apelit.

20 Keni të drejtën të mos mbaheni i ndaluar për një periudhë
21 të paarsyeshme kohore para fillimit të çështjes gjyqësore
22 tuajën dhe keni të drejtën të liroheni në goftë se Prokurori i
23 Specializuar nuk dorëzon aktakuzë kundër jush më së paku
24 brenda një viti.

25 Keni të drejtën për një gjykim brenda një afati të

1 arsyeshëm dhe të lirohëni në qoftë se plotësohen kriteret
2 përkatëse.

3 Keni të drejtën për avokat dhe pa pagesë në qoftë se nuk
4 keni mjetet financiare për ta paguar avokatin.

5 Keni të drejtën për të pasur kohë dhe mjete të
6 mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes suaj ose të komunikoni
7 me Avokatin që zgjidhni ju vetë.

8 Keni të drejtën për përkthyes falas nëse nuk e kuptoni
9 apo nuk e flisni gjuhën që përdoret në gjykatë.

10 Keni të drejtën të mos detyrohëni të dëshmoni kundër
11 vetes suaj apo të pranoni fajësinë.

12 Keni të drejtën të qëndroni në heshtje dhe nuk do të ketë
13 asnjë pasojë negative nga heshtja juaj.

14 Z. Kilaj, dëgjuat të drejtat më të rëndësishme që gëzoni
15 si i dyshuar i ndaluar në përputhje me kornizën ligjore në
16 fuqi të Dhomave të Specializuara.

17 Z. Kilaj, i kuptuat këto të drejta?

18 I DYSHUARI: Po.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Kilaj.

20 Dua t'ju informoj se në përputhje me nenin 21(5) të
21 Ligjit, nuk mund të përfaqësoni veten tuaj sepse aktualisht
22 jeni në paraburgim, prandaj është i detyrueshëm që të jeni i
23 përfaqësuar me avokat.

24 Është detyra ime si Gjykatës i Vetëm të garantoj që e
25 drejta juaj për avokat të jetë respektuar. Për këtë qëllim,

1 kam njoftuar Zyrën Administrative -- kam marrë parasysh
2 njoftimin e Zyrës Administrative të datës 3 nëntor se ju është
3 caktuar një avokat. Po ashtu kuptoj nga dokumenti i Zyrës
4 Administrative që ju është caktuar z. Iain Edwards si Avokat
5 kujdestar në përputhje me kreun 17(2) të Direktivës për Avokat
6 dhe Rregullores 21 për Ndhimën juridike.

7 Z. Kilaj, a mund të konfirmoni që z. Iain Edwards është
8 caktuar si Avokat Mbrojtës për ju?

9 I DYSHUARI: Po.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Kilaj.

11 I dyshuari pra përfaqësohet me avokat siç duhet të ndodhë
12 me ligj.

13 Vërej që në përputhje me nenin 41(3) të Ligjit dhe
14 rregullën 52(2) të Rregullores, do të vendos lidhur me lirimin
15 apo vazhdimin e paraburgimit të personit brenda 48 orësh nga
16 momenti që personi i ndaluar është sjellë para meje.

17 Vërej në këtë drejtim që ZPS-ja ka dorëzuar një kërkesë
18 për vazhdimin e paraburgimit të të dyshuarit më 3 nëntor 2023.

19 Z. Prokuror, ju lutem, a mund të paraqisni me gojë
20 parashtrimet tuaja me shkrim lidhur me këtë pikë?

21 Para se t'ju jap fjalën dua t'ju kujtoj palëve të bëjnë
22 njoftim paraprak në qoftë se ndonjë prej, ndonjë prej
23 parashtrimeve përmban informacion konfidencial, në mënyrë që
24 të kalojmë në seancë private nëse është nevoja.

25 Z. Prokuror, fjala është për ju.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatës. E kuptojmë
2 që parashtrimi i protokolluar që përmendët ju, që është F00096
3 [sipas përkthimit], i është njoftuar edhe Avokatit Mbrojtës.

4 Unë nuk do të përsëris çdo gjë që përmban ky dokument,
5 thjesht do të jap disa informacione shtesë. Për ta bërë këtë
6 do të donim që të kalonim në seancë private për rreth dy
7 minuta dhe pastaj mund të dalim sërish në seancë publike ku
8 mund të bëj të ditur edhe qëndrimin e ZPS-së.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në rregull, kalojmë në
10 seancë private. Ftoj Prokurorinë që të jemi sa më pak në
11 seanca private, kështu që përpiqemi sa më shumë që të jetë e
12 mundur që të jemi në seancë publike.

13 Z. HALLING: [Përkthim] E kuptoj.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Sekretare e Gjykatës, të
15 kalojmë në seancë private.

16 [Seancë private]

17 [Seancë private teksti i fshirë]

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24 [Seancë e hapur]

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

2 Z. Prokuror, mund të vazhdoni.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

4 Ndalimi i Z. Kilaj është i domosdoshëm në përputhje me
5 Ligjin, me nenin 41(6) të Ligjit. Në këtë rast vlejné të tre
6 rreziqet e parashikuara në këtë nen sikurse thuhet me hollësi
7 në parashtrimin tonë.

8 Ai ka rrezik ikjeje, përballet me vepra që mund të
9 dënohen deri në pesë vite. Ka arsye që të ikë nga
10 juridiksioni, përfshirë në vende të treta ku mund të mos
11 pranohet ekstradimi i tij.

12 Natyra e materialeve të gjetura tregon gjithashtu se
13 ekziston rreziku që z. Kilaj do të shkatërrojë, fshehë,
14 ndryshojë apo të falsifikojë provat e një krimi, apo se do të
15 pengojë ecurinë e procesit duke ndikuar tek dëshmitarët,
16 viktimat apo bashkëpunëtorët e tyre. Në fakt, materialet e
17 gjetura sugjerojnë se z. Kilaj është marrë pikërisht me këtë
18 lloj sjelljeje.

19 Dhe fushëveprimi i materialeve të sekuestruara tregon se
20 është një lloj modeli i një sjelljeje penguese dhe ekziston
21 kështu rreziku se do t'i përsërisë këto lloj veprash pa u
22 ndaluar.

23 Në fund, rastet që trajtohen në këtë Gjykatë zhvillohen
24 në një klimë të qartë të frikësimit të dëshmitarëve. Se kjo
25 klimë ekziston, kjo tregohet dhe nga, ndër të tjera, shpallja

1 fajtores e Guçatit dhe Haradinajt dhe konstatimi juaj lidhur me
2 çdo çështje të paraqitur përpara Trupit Gjykses.

3 Neve duam t'ju tërheqim vëmendjen gjithashtu në
4 parashtrimin e KSC-së [sipas përkthimit] që është KSC-BC-2020-
5 06, F005/RED [sipas përkthimit] në çështjen Thaçi dhe të tjerë
6 për citime të tjera që provojnë këtë që po them.

7 Informacioni, çdo të thotë informacioni në zotërim të z.
8 Kilaj, duhet të kuptohet në këtë kontekst. Mbajtja e
9 materialeve të tilla tregon një mungesë të vetëdijshme për
10 respektimin e urdhrave të Gjykatës dhe nuk ka asnjë masë
11 tjetër që mund ta zbusi këtë lloj rrezique.

12 Për këtë arsye dhe siç e kemi parashtruar në parashtrimin
13 tonë, z. Kilaj duhet të mbahet i ndaluar.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

15 Tani, i kthehem Mbrojtjes, Avokatit të Mbrojtjes.

16 Z. EDWARDS: [Përkthim] Faleminderit.

17 Mbrojtja e ka parasysh mocionin e Prokurorisë që, i cili
18 thotë që z. Kilaj duhet të mbahet i ndaluar. Që është
19 paraqitur dje në orën 11.00.

20 Propozoj t'i përgjigjem në fund të ditës me qëllim që ju,
21 i nderuar Gjykatës, të ketë parashtrimin e Mbrojtjes përpara
22 se, para se të përcaktoni nëse z. Kilaj do të vazhdojë të
23 mbahet i ndaluar apo do të lirohet. Dhe këtë e bëni deri, do
24 ta bëni të hënën në mëngjes, pra.

25 Atëherë, me lejen tuaj, do të kërkoj që të mos jepni

1 vendim pa marrë këtë parashtrim tonin. Parashtrimet do të jenë
2 shumë më të hollësishme sesa gjithçka tjetër që mund të thoja
3 sot përpara jush. Me lejen tuaj, megjithatë, ka nja dy gjëra
4 që mendoj se janë të rëndësishme për ju dhe për publikun që të
5 kuptojë, t'i kuptojë. Pra, kam disa parashtrime që dua t'i bëj
6 tani, disa prej të cilave do të, për disa prej të cilave duhet
7 të kalojmë në seancë private.

8 Pra, siç thatë dhe ju me të drejtë, nuk ka aktakuzë në
9 këtë moment. Nuk do të ketë deklaram, vetëdeklaram, sot apo pa
10 kaluar 30 ditë. Nuk do të ketë pra paraqitje të aktakuzës në
11 një të ardhme të afërme, po të jemi realistë. Nuk e dimë se
12 kur mund të bëhet, mund të kalojnë shumë, shumë, muaj që nga
13 sot. Dhe shumë muaj të tjerë përpara se sa të merret vendimi i
14 konfirmimit sipas rregullës 86(5).

15 Ndërkohë, çfarë do të ndodhë me z. Kilaj? Në qoftë se
16 Prokuroria, në qoftë se do të bëhet siç thotë Prokuroria, ai
17 duhet të presë derisa të bëhet aktakuza, përderisa të
18 konfirmohet, pra, vendimi, i ndaluar larg nga shtëpia, larg
19 nga familja e tij, ai do të vazhdojë të jetë në një situatë të
20 cenueshme, rreth 2000 km larg nga shtëpia e tij, nga ku u mor
21 në 2 nëntor.

22 Ai duhet të presë derisa Prokuroria të përfundojë hetimet
23 e veta dhe pastaj të hartojë aktakuzën, dhe pastaj ta paraqesë
24 atë aktakuzë. Dhe ndërkohë ai nuk mund të bëjë asgjë që ta
25 detyrojë Prokurorinë ta përshpejtojë këtë proces.

1 Nëse do të kishte një aktakuzë përpara jush sot, të
2 nderuar Gjykatës, z. Kilaj sot do të paraqitej, do të
3 deklarohej, do të paraqitesh akuzë, dhe nuk do të diskutohej e
4 drejta e tij për të pritur 30 ditë. Ai do t'ju thoshte tani
5 menjëherë se nuk është fajtor për asnjë nga akuzat që
6 Prokuroria mund të dojë t'i paraqesë kundër tij. Ai, kaq i
7 përgatitur është ai për të bashkëpunuar plotësisht me këtë
8 Trupi Gjykses, me këtë Gjykatë, me Prokurorinë.

9 Dua të theksoj sesa të pabazuara janë akuzat e
10 Prokurorisë, dhe do të përpiqem të ngre disa çështje
11 publikisht për këtë, por për të qenë shumë të kujdesshëm, dhe
12 duke pasur parasysh mënyrën se si kolegët e paraqitën çështjen
13 nga ana e tyre për vazhdimin e paraburgimit, dëshiroj të
14 kalojmë në seancë private për një apo dy minuta.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, Mbrojtës.

16 Të kalojmë, ju lutem, në seancë private.

17 [Seancë private]

18 [Seancë private teksti i fshirë]

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22 [Seancë e hapur]

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

25 Vazhdoni.

1 Z. EDWARDS: [Përkthim] Për ta përmbledhur, thjesht nuk ka
2 asnjë lloj prove që z. Kilaj është fajtor për asnjërën nga
3 veprat për të cilat -- nuk është akuzuar, por që Prokuroria
4 pretendon se i ka kryer. Ka faktorë themelorë për këto dy
5 vepra të pretenduara që në fakt mungojnë.

6 Akuzat ndaj tij janë, siç thashë, shumë të pabaza, dhe
7 nuk mund të shqyrtohen.

8 Kam aluduar për gatishmërinë e z. Kilaj për të
9 bashkëpunuar, se ai nuk do të deklarohet fajtor sapo t'i jepet
10 rasti, dhe për të treguar se është i pafajshëm dhe emri i tij
11 duhet të dalë, të pastrohet, pra. Është thjesht për mendimin
12 tim qëndrimi i tij është që ai vazhdon të, është i gatshëm të
13 bashkëpunojë me Prokurorinë që e ka treguar që në fillim të
14 këtij procesi.

15 Do të shikoni në raportin për arrestimin e tij, dhe është
16 parashtrimi 392 i djeshëm, dhe nuk mund ta marr me mend që të
17 ketë ndonjë gjë konfidenciale apo private, por nuk janë
18 përdorur në asnjë moment prangat ndaj tij.

19 Dhe një herë, nuk mund ta marr me mend se, nuk mund të më
20 shkojë mendja se ka ndonjë gjë konfidenciale lidhur me këtë që
21 po them, por ju mund ta keni parasysh nga parashtrimi i
22 Prokurorisë se z. Kilaj ka bashkëpunuar me vullnet të lirë në
23 arrestimin e tij.

24 Dy gjëra. E para është që duhet të ketë ndonjë problem me
25 datën e Prokurorisë, po to shikojmë kronologjinë, sesi mund të

1 jetë intervistuar ai në 2 nëntor kur është informuar për të
2 drejtat e tij pas mesnatës. Por megjithatë, sigurisht që çdo
3 Avokat do të tmerrohej nga fakti që një klient do të hiqte
4 dorë nga e drejta e tij për të mos folur, për të mos u
5 ndihmuar nga një avokat, gjatë intervistës, përpara sesa të
6 shoh qoftë edhe një fiye prove. Por këtë e ka bërë z. Kilaj,
7 kaq i gatshëm është ai që të bashkëpunojë. Ai ra dakord që të
8 intervistohet në mënyrë të vullnetshme.

9 Ai është gati 60 vjeç. Do t'i mbushi 60 vjeç në dhjetor.
10 Është një familjar, i martuar prej gati 40 vitesh me gruan. Ka
11 disa fëmijë. Ka jetuar në Malishevë gjatë gjithë jetës së tij.
12 Dhe ka lidhje jashtëzakonisht të forta me komunitetin, dhe nuk
13 përbën asnjë rrezik për t'u fshehur apo për të ikur, ndryshe
14 nga ç'thotë Prokuroria në parashtrimet e veta. As për arsyet
15 që aluduan ata në seancë private, nuk ekziston rreziku më i
16 vogël që ai të kërkojë të pengojë procesin apo të kryejë
17 ndonjë vepër penale. Ai ka karakter të mirë. Një 60 vjeçar që
18 nuk është dënuar, nuk është shpallur kurrë fajtor në asnjë
19 lloj procesi penal. Nuk është arrestuar ndonjëherë më parë
20 përpara 2 nëntorit. Sigurisht nuk është, as nuk mbajtur i
21 ndaluar. Këto janë dy netët e fundit që ai ka qenë i
22 paraburguar, në paraburgim.

23 Parashtrimet e mia do të paraqiten më gjerësisht me
24 shkrim në fund të ditës që ju t'i keni parasysh t'i shqyrtoni
25 përpara se sa të merrni vendim për vazhdimin e paraburgimit të

1 tij deri të hënën në mëngjes. Por për sot, mjafton të themi që
2 është kandidat jashtëzakonisht i mirë për ta liruar
3 përkohësisht në Kosovë. Nëse do të lirohet ai sigurisht do t'u
4 përmbahet çdo kushti që do t'i vihet, sipas nenit 41(12) që ju
5 mund ta shihni të përshtatshme.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

7 Prokurorisë, Prokuroria dëshiron të përgjigjet?

8 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Në qoftë se do të ketë
9 parashtrim me shkrim, duam dhe ne të na jepet mundësia t'i
10 përgjigjemi. Për sa i takon parashtrimeve me gojë, duam t'u
11 përgjigjemi tani.

12 Disa gjëra në përgjigje. Atë që tha Avokati në fillim të
13 parashtrimeve kishin të bënë me aktakuzën, kur do të vijë kjo
14 aktakuzë. Kjo është spekulative, sepse nuk kemi ardhur në atë
15 moment. Ne po punojmë sa më shpejt që të jetë e mundur të
16 analizojmë materialet dhe ta përgatitim aktakuzën sa më shpejt
17 që të jetë e mundur. Dhe parashtrimet e Mbrojtësit nuk janë të
18 bazuara lidhur me kohën e mbajtjes të ndaluar të dyshuarit.

19 Për sa i takon natyrës të pabazë të aktakuzave, ne nuk
20 jemi dakord. Gjykata varet nga dëshmitarë që vijnë këtu dhe që
21 thonë dëshmi, paraqisin dëshmitë e tyre, dhe këto, kjo është
22 një gjë që Zyra jonë e merr me shumë seriozitet në çdo kohë.

23 Për sa i takon fjalëve të Mbrojtësit në seancë private,
24 duam të ngremë një çështje, por për këtë duam të shkojmë, të
25 kalojmë në seancë private.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Sekretare, të kalojmë në

2 seancë private.

3 [Seancë private]

4 [Seancë private teksti i fshirë]

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9 [Seancë e hapur]

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

12 Avokat, doni të kundërpërgjigjeni parashtrimeve të ZPS-
13 së?

14 Z. EDWARDS: [Përkthim] Shkurtimisht, vetëm për këtë pikën
15 e fundit.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mos duhet të kalojmë në
17 seancë private?

18 Z. EDWARDS: [Përkthim] Jo, nuk është nevoja. Besoj se
19 mund t'i bëj dhe në seancë publike. Diçka shumë të thjeshtë
20 dua të them.

21 Parashtrimet e Prokurorisë duket sikur thonë që duhet të
22 ketë qenë, duket të ketë ekzistuar vetëm një burim. Po kjo nuk
23 është e mbështetur me prova. Kaq do thojë.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, Avokat.

25 Do të vendos lidhur me parashtrimet tuaja në fund të

1 seancës pasi të bëjmë një pushim të shkurtër.

2 Tani, të flasim për gjuhën e punës së procesit gjyqësor.
3 Marr parasysh që në bazë të Vendimit për Gjuhën e Punës që
4 është nxjerrë më 5 dhjetor 2019, përkatësisht është dokumenti
5 me numër F0078 [sipas përkthimit], gjuha e punës për procesin
6 gjyqësor dhe hapat hetimorë, është anglishtja.

7 U lutem palëve në këtë moment të na thonë cila është
8 gjuha që parapëlqejnë të përdoret në këtë çështje të re në
9 përputhje me rregullën 8?

10 I drejtohem Prokurorit fillimisht.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Ne preferojmë gjuhën angleze.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

13 Avokat?

14 Z. EDWARDS: [Përkthim] A më lejoni -- më jepni një moment
15 që të diskutoj me klientin tim në lidhje me këtë?

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Patjetër.

17 [Përfaqësuesi i Mbrojtjes dhe i dyshuari
18 këshillohen]

19 Z. EDWARDS: [Përkthim] Duke pasur parasysh që unë jam
20 thjesht Avokati Mbrojtës dhe në një fazë të mëvonshme mund të
21 ketë avokat tjetër, por për momentin themi që është
22 anglishtja, duke marrë parasysh që gjithçka do të përkthehet
23 në shqip, shpresojmë, për hir të klientit tim.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po, do marr dhe vendim në
25 lidhje me këtë aspekt.

1 Tani dua të flas për aspektin tjetër, që është çelja e
2 një lënde të re. Synoj të urdhëroj Zyrën Administrative të
3 çelë një lëndë të re në Gjykatën Themelore e cila do të ketë
4 titullin Prokurori kundër Isni Kilaj. Po ashtu synoj të
5 urdhëroj Zyrën Administrative të kopjojë dhe transferojë një
6 sërë parashtrimesh të protokolluara dhe vendimesh si dhe
7 përkthimet përkatëse nga dosja hetimore në çështjen e re
8 gjyqësore.

9 Kjo ka lidhje me parashtrimet dhe vendimet që kanë të
10 bëjnë me z. Kilaj dhe që më pas mund të jenë të rëndësishme
11 për përgatitjen e Mbrojtjes së tij në qoftë se do të dorëzohet
12 një aktakuzë nga ZPS-ja dhe sigurisht nëse kjo aktakuzë do të
13 konfirmohet.

14 Për të marrë një vendim sa më të matur, synoj të urdhëroj
15 Zyrën e Prokurorit të Specializuar të bëjë parashtrime me
16 shkrim në lidhje me këtë aspekt.

17 Z. Prokuror, keni gjë për të shtuar lidhur me këtë aspekt
18 para se të kaloj te pika tjetër në rendin e ditës? Nuk dua që
19 të më rendisni parashtrimet e protokolluara, por a keni ndonjë
20 pyetje? Para se të nxjerr një urdhër me gojë në fund të
21 konferencës për ecurinë e çështjes gjyqësore.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Jo nuk kemi asgjë për të thënë për
23 momentin.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Prokuror.

25 Mbrojtja, ka diçka për të thënë në lidhje me këtë?

1 Z. EDWARDS: [Përkthim] Jo.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

3 Në rregull atëherë, ftoj Zyrën e Prokurorit të
4 Specializuar të na thotë cilat janë hapat e ardhshëm
5 proceduralë, veçanërisht kur synojnë të dorëzojnë aktakuzën
6 kundër z. Kilaj.

7 E di që mbase nuk është e qartë tamam në këtë moment, por
8 dua të kujtoj Prokurorin e Specializuar se kemi një person të
9 dyshuar, aktualisht të arrestuar, dhe unë dua që procesi
10 gjyqësor të jetë i drejtë dhe i shpejtë, shumë i shpejtë, si
11 zakonisht.

12 Z. Prokuror.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Ne do të punojmë shumë shpejt në
14 mënyrë që të garantohemi që aktakuza të dorëzohet sapo të jetë
15 e mundur, siç mund ta kuptoni i nderuar Gjykatës, ka disa hapa
16 që duhet të ndërmerim në mënyrë që aktakuza të dorëzohet
17 bashkë me materialet mbështetëse që i kemi marrë vetëm
18 rishtazi.

19 Disa nga hapat që ne synojmë të ndërmerim javët e
20 ardhshme janë këto: të analizojmë materialet që kemi marrë nga
21 kontrolli i banesës, veçanërisht ato që kemi diskutuar në
22 seancë private. Duhet të mbledhim informacione nga personat që
23 janë implikuar në informacionet e sekuestruara, për të
24 përcaktuar kuadrin e përgjegjësisë penale dhe duhet të
25 analizojmë intervistën që dha z. Kilaj për ZPS-në si i dyshuar

1 dhe çdo hap që buron prej kësaj.

2 Në këtë drejtim dhe në lidhje me pikën e mëparshme në
3 rendin e ditës, shumë prej informacioneve që kemi mbledhur në
4 këtë hetim më pas duhen përkthyer nga shqipja në anglisht si
5 për të ndihmuar ZPS-në me analizën e vetën, por dhe që të ketë
6 mundësi që t'i shohë Trupi Gjykues apo Gjykata në mënyrë që të
7 përgatitet dhe aktakuza.

8 Këto janë disa nga hapat, ne po bëjmë të pamundurën të
9 punojmë sa më shpejt dhe do përpiqemi që aktakuzën t'jua
10 dorëzojmë sa më shpejt të jetë e mundur.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

12 I drejtohem Avokatit. Avokat, keni parashtrime lidhur me
13 këto që sapo tha Prokurori?

14 Z. EDWARDS: [Përkthim] Asgjë, unë thjesht theksoj pikat
15 që ngrita më herët. Ky është proces që nuk i dihet fundi, jemi
16 në fillim të këtij procesi.

17 Me përjashtim të aspekteve apo gjërave që u aluduan në
18 seancë private lidhur me ato që janë sekuestruar nga i
19 akuzuari, ka pasur dhe disa pika të tjera që tradicionalisht
20 si rregull janë gjëra që duhen hetuar më tej. Është shumë e
21 vështirë ta kuptojmë sesi do të kryhet kjo brenda pak javësh.
22 Sepse bëhet fjalë për muaj, me sa kuptoj unë, s'mund të bëhet
23 kjo gjë për javë, për disa javë. Rrjedhimisht, e kërcënon
24 shumë z. Kilaj dhe z. Kilaj nuk mund të qëndrojnë në paraburgim
25 që Prokuroria të mbledhë prova dhe të bëjë punën e vet.

1 Përveç kësaj nuk kam asnjë parashtrim tjetër.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, Avokat.

3 Z. Prokuror, a mund të jepni ndonjë hollësi lidhur me
4 afatin kohor. Edhe unë sikurse Avokati dua të kuptoj a bëhet
5 fjalë për javë, apo bëhet fjalë për muaj? Pra kam edhe unë të
6 njëjtën pyetje si Avokati.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Po, përgjigjja varet nga analiza
8 që do të kryejmë ne duke filluar që tani me materialet që
9 kemi. Por ne propozojmë që ju, i nderuar Gjykatës, të na
10 caktoni ne një afat lidhur me njoftimet që duhet të bëjmë për
11 të ardhmen. Për shembull, diku nga data 20 nëntor. Sepse kjo
12 na jep ne kohë të mjaftueshme për të analizuar materialin që
13 kemi sekuestruar dhe t'u japim përgjigje përfundimtare.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Pra nuk jeni në gjendje të
15 na thoni sot kur do ta dorëzoni aktakuzën?

16 Z. HALLING: [Përkthim] Po varet shumë nga analiza e
17 materialit që sapo kemi marrë. Sapo na e sollën në Zyrë, një
18 pjesë e morëm dje, sot është e shtunë, e kam shumë të vështirë
19 të jap një parashikim kohor se ende nuk e dimë çfarë materiali
20 kemi.

21 Por mund t'ju them që në 20 nëntor, javën e 20 nëntorit,
22 ne do të jemi në gjendje t'ju japim një parashikim më të
23 saktë.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, Prokuror.

25 Pyes palët tashmë a ka ndonjë aspekt që duan të ngrenë

1 tani para se të bëjmë një pushim të shkurtër dhe më pas të
2 kthehemi për të dhënë urdhër me gojë.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Jo nga Prokuroria.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Avokati?

5 Z. EDWARDS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, thjesht një
6 sqarim, që ta kem unë parasysh.

7 Në faqen 22 të transkriptit, rreshti 6 dhe 7, ju thatë se
8 do të merrni vendim lidhur me parashtrimet, me gojë. Këtë
9 përshtypje, kjo përshtypje m'u krijua mua nga ajo që thatë, i
10 nderuar Gjykatës. Pra po thoni që do të jepni vendim me gojë
11 lidhur me çështjen e paraburgimit sot, bazuar në parashtrimet
12 e mia me gojë? Nuk do të prisni deri të hënën që të kem
13 dorëzuar unë dhe parashtrime me shkrim?

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Fillimisht do të marr
15 vendim lidhur me parashtrimet tuaja dhe këtë do ta bëj. Dhe
16 pastaj në varësi të vendimit tim unë mund të marr një vendim
17 tjetër ose jo me gojë.

18 Z. EDWARDS: [Përkthim] E kuptoj, por unë po përpiqem të
19 them këtë, i nderuar Gjykatës. Parashtrimet e mia me gojë
20 ishin thjesht për të theksuar disa pika që unë synoja apo
21 parapëlqej t'i shtjelloja më tej me shkrim, sikurse pati
22 mundësi dhe Prokuroria.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] E marr parasysh Avokat,
24 këtë që sapo thatë.

25 Z. Kilaj, para se të bëjmë një pushim të shkurtër,

1 dëshiroj t'ju pyes a ka ndonjë aspekt që doni ta ngrini lidhur
2 me arrestimin tuaj, transferimin tuaj apo paraburgimin tuaj në
3 këtë moment?

4 I DYSHUARI: Jo.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Kilaj. Do
6 bëjmë tani 20 minuta pushim, pak a shumë, për afërsisht. Do
7 kthehemi për të përfunduar seancën. Seanca për momentin
8 ndërpritet për 20 minuta.

9 --- Pauza fillon në orën 10.53

10 --- Seanca rifillon në orën 11.19

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Do të nxjerr urdhrin e
12 parë.

13 Pasi dëgjova palët, dhe duke marrë parasysh kërkesën e
14 Prokurorisë për vazhdimin e paraburgimit që u paraqit dje, në
15 3 nëntor, rreth orës 22.00, e quaj të përshtatshme të miratoj
16 kërkesën e Mbrojtjes për të bërë parashtrime me shkrim lidhur
17 me këtë kërkesë përpara se të jap vendimin tim.

18 Prandaj, e urdhëroj Mbrojtjen e z. Kilaj të parashtojë
19 parashtrimet e veta me shkrim sot, 4 nëntor deri në orën 20.00
20 dhe ZPS-në t'i përgjigjet nesër deri në orën 14.00.

21 Të hënën në orën 10.00, 6 nëntor do të nxjerr vendimin
22 tim.

23 Gjithashtu, urdhëroj z. Kilaj të vazhdojë të qëndrojë në
24 paraburgim deri në pritje të vendimit tim.

25 Këtu përfundon urdhri i parë.

1 Tani, do të nxjerr urdhrin e dytë lidhur me transferimin
2 e parashtrimeve në dosjen e çështjes.

3 Urdhëroj Prokurorin e Specializuar të dorëzojë
4 parashtrime me shkrim me listën e parashtrimeve të propozuara
5 që lidhen me të dyshuarin, z. Kilaj, të kopjohen dhe të
6 transferohen nga dosja hetimore në dosjen e re të çështjes
7 deri të martën 7 nëntor 2023, më e fundit.

8 Këtu përfundon urdhri i dytë me gojë.

9 Tani dëshiroj t'i informoj palët dhe Zyrën Administrative
10 se do të planifikoj një konferencë tjetër në momentin e duhur,
11 lidhur me ecurinë e çështjes dhe për të trajtuar çështje të
12 tjera që mund t'i ngrenë palët.

13 Këtu përfundon seanca e sotme. Falënderoj palët, Zyrën
14 Administrative, përkthyesit, teknikët, stenografin dhe
15 personelin e sigurisë për ndihmën e tyre.

16 Këtu përfundon seanca e sotme.

17 --- Paraqitja e parë mbyllet në orën 11.21

18

19

20

21

22

23

24

25